

## Terma dhe Kushte

### Shërbimi e-Sigurime nga klientët e BKT

Kushtet e përdorimit të shërbimit nga kanalet dixhitale të BKT për pagesat e policave të sigurimit

- Klienti, pranon dhe është i informuar për kushtet e përgjithshme të Kontratës së Shërbimeve Bankare Individuale, Shërbimet Bankare Elektronike nënshkruar prej tij.
- BKT përmes kanaleve të saj dixhitale, në bashkëpunim me Kompanitë e Sigurimit, ka krijuar mundësinë teknike për rezervimin dhe pagesën e policave të sigurimit.
- Kompania e Sigurimit dhe BKT garantojnë, secila në platformat e saj respektive, që kanë marrë të gjitha masat e mjaftueshme për aplikimin e teknologjive bashkëkohore dhe procedurave specifike si kërkesë ligjore për ruajtjen e të dhënave personale të klientëve.
- Në kanalet dixhitale të BKT do të shfaqen Kompanitë e Sigurimit me të cilat BKT ka marrëveshje bashkëpunimi për këtë qëllim.
- Në kanalet dixhitale të BKT do të shfaqen vetëm produktet e Sigurimit të cilat janë dakordësuar me Kompanitë e Sigurimit, të cilat mund të paguhen dhe rezervohen përmes kanaleve dixhitale të BKT.
- Përdoruesit e Kanaleve Dixhitale të BKT, kanë mundësinë që përmes integritit të platformës me Kompanitë e Sigurimit të rezervojnë dhe të paguajnë një policë sigurimi.
- Kompania e Sigurimit përcakton primet (çmimet) e policave të sigurimit.
- Klienti duhet të plotësojë të dhënat e nevojshme, në fushat përkatëse, të domosdoshme, që Kompania e Sigurimit të ketë mundësi të gjenerojë një policë sigurimi të saktë, me të gjithë elementët e nevojshëm të policës.
- Klienti autorizon BKT të përcjellë këto të dhëna të Shoqëria e Sigurimit për të patur një kuotim për policën e sigurimit që kërkon të blejë. Pëlqimi i mësipërm është dhënë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 20, datë 03.08.2021 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar”.
- BKT garanton që pagesa e primit të policës së sigurimit të kryhet në mënyrë të saktë në llogarinë e Kompanisë së Sigurimit të përzgjedhur nga klienti.
- Polica e sigurimit ose konfirmimi i lëshimit të policës së sigurimit do mundësohet pas pagesës, me e-mail nga Kompania e Sigurimit.
- Në çmimin e pagueshëm janë të përfshira taksat dhe tatimet që i ngarkohen primit të sigurimit.
- BKT nuk do të përfitojë komision shtesë mbi primin nga klienti në momentin e pagesës së policës së sigurimit.
- Kompania e Sigurimit është përgjegjëse për dërgesën e policës elektronike apo konfirmimit të lëshimit të policës së sigurimit menjëherë pas pagesës dhe për dërgesën e policës në format pdf me mjete elektronike komunikimi. Polica konsiderohet e lëshuar menjëherë pas marrjes së policës elektronike me e-mail nga kompania e sigurimit.
- Kompania e Sigurimit është përgjegjëse që nëpërmjet sistemeve të integruara të verifikojë të dhënat e vendosura nga klienti kur rezervon dhe paguan policën, nëse një policë sigurimi mund të lëshohet ose jo.
- Kopja elektronike e policës i dërgohet klientit nga Kompania e Sigurimit në adresën e përcaktuar prej tij.

- Klienti me konfirmimin e pagesës pranon që është i njohur me kushtet e përgjithshme të policës së sigurimit për të cilën po paguan primin, në faqen zyrtare web apo çdo kanal komunikimi zyrtar të Shoqërisë së Sigurimit.
- Për të marrë informacion mbi kushtet e ofrimit të produkteve të sigurimit klienti mund të vizitoj faqen zyrtare të Shoqërisë së Sigurimit Sigal <https://sigal.com.al/> ose të kontaktoj në numrin e telefonit +355 4 22 33 308.
- Primi i papërdorur transferohet nga Kompania e Sigurimit në llogarinë e klientit. Kjo është procedure ekskluzive e kompanisë së Sigurimit.
- BKT nuk është përgjegjëse për shërbimin që rrjedh në mënyrë direkte apo indirekte nga zbatimi i kushteve të policës së sigurimit, të tilla si trajtimi i dëmeve, praktika e dëmshpërblimit si afati e kërkesës për dëmshpërblim apo/dhe afatet e kompanisë së sigurimit për t'u përgjigjur, zbatimi i kushteve të policës së sigurimit, masa e dëmshpërblimit, etj. Ç përgjegjësi në lidhje me zbatimin e policës së sigurimit dhe kushteve të saj, është tërësisht përgjegjësi e Kompanisë së Sigurimit që ka lëshuar policën e sigurimit.
- Kompania e sigurimit dhe BKT kanë të drejtë të ndërpresin Shërbimin për një periudhë të pacaktuar në rast mirëmbajtje të rjetit, përditësime sigurie, përditësime teknike, vendim të institucioneve shtetërore për të ndërprerë shërbimin etj.
- BKT në bashkëpunim me Kompaninë e Sigurimit mund të vendosë për oferta promovionale për një produkt sigurimi të caktuar dhe për një periudhë të caktuar, për klientët përdorues të kanaleve dixhitale të BKT.
- Për blerjen e policave të sigurimit nga ATM, klienti nuk do të hyjë në Overdraft. Pagesa do të ekzekutohet vetëm nëse klienti ka balancë pozitive në llogarinë primare.

### **Kushtet e anulimit të policës së sigurimit:**

- Klienti ka të drejtë të kërkojë anulimin e policës para fillimit të periudhës së sigurimit dhe të kërkojë rimbursimin e pagesës së kryer duke njoftuar zyrtarisht BKT përmes kanaleve zyrtare të komunikimit.
- Në rast se polica ka hyrë në fuqi, por jo me vonë se 2 (dy) ditë pune për policën e Shëndetit në Udhëtim dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune për policën AutoSOS, nga data e lëshimit të policës, klienti mund të bëjë kërkesë zyrtare për anulimin e policës së sigurimit. Kërkesa merret në shqyrtim nga kompania e sigurimit dhe BKT, ku më pas konfirmohet anulimi dhe kthimi i fondeve.
- Në rast se kërkesa për anulim bëhet 2 (dy) ditë pas lëshimit të policës së sigurimit për policën e Shëndetit në Udhëtim dhe 5 (pesë) ditë pas lëshimit të policës për policën AutoSOS, kompania e sigurimit nis procedurën e ndërprerjes së policës ku mban dhe primin për periudhën e përdorur, duke kthyer primin për periudhën e papërdorur dhe duke mbajtur gjithashtu kostot administrative sipas politikave të saj.